



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/ L-040, nenin 5.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, dhe nenit 25.1 të Rregullores së punës të Kuvendit të Komunës së Podujevës,

### THËRRAS

Mbledhjen e LIII-të (pesëdhjetë e tre - mandati VI) të Kuvendit të Komunës së Podujevës, e cila do të mbahet më **30 korrik 2021, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re e Komunës së Podujevës, në orën 10;00, me këtë:**

1. **Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më:**  
**04 qershor 2021 dhe 13 korrik 2021**
2. **Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit, për pasqyrat vjetore financiare të komunës së Podujevës për vitin 2020**  
**- *Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit***
3. **Propozim Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksa, tarifa dhe Gjoha Komunale**  
**- *Raporti nga diskutimi / debati publik***
4. **Informatë e Drejtorisë së Arsimit për vitin shkollorë 2020 – 2021**
5. **Informatë e përgjithshme e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit.**
6. **Anulimi i Rregullores nr.prot.01-560/03-0045216/21 të datës 04.06.2021 për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës.**  
*(Për arsye se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përmes Ministrisë së Pushtetit Lokal e ka përcjellë shkresën e Zyrës së Kryeministrit sipas të cilës akti në fjalë nuk është në harmoni me Ligjin për mbrojtjen e fëmijës nr.06/L-084)*
7. **Të ndryshme**

*Mbledhja mbahet duke respektuar masat sipas vendimeve dhe akteve tjera të nxjerra nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe rekomandimeve të IKSHPK lidhur me situatën nga Pandemia Covid-19*

**Nr. 01-060/03-0058189/21**  
**Podujevë, 19 korrik 2021**



**Kryesnesi i Kuvendit**  
**Fatmir Gashi**